

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BENVENUTO” SHPK

Sot më datë 29.08 2023 (dy mijë e njëzetë e tre), në Tiranë, duke u bazuar në Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me vullnetin e tyre të lirë, kanë vendosur themelimin e kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, personat e mëposhtëm:

- **1. Kelvin Kalari**, i biri i Eqerem-it dhe i Shpresa-s, lindur më 29.09.1998, në Tiranë, Shqipëri dhe banues në adresën: Tiranë, rruga “Ramë Sadria”, shtëpi private nr. 108, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me Nr.Personal J80929056T.
- **2. Hamza Salla**, i biri i Seit-it dhe i Sadete-s, lindur më 20.08.1996, në Plangaricë dhe banues në adresën: Tiranë, Mullet, pranë Njesisë Administrative, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit elektronik me Nr.Personal J60820014R.

Neni 1
Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është “Benvenuto” Shpk.

Neni 2
Selia

Selia e shoqërisë është në adresën: Tiranë, rruga “Vasil Shanto”, P.4, Sh.1, K.1, hyrja 1, Ap.4, zona kadastrale 8260, nr. Pasurie 4/25+1-4 .

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

Neni 4



Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimeve të bar- kafesë dhe restorantit.

Neni 5

Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 (një mijë) lekë.
- Ky Kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët e shoqërisë **Kelvin Kalari**, në vlerën 500 (pesëqind) lekë, përkatësisht 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë dhe **Z. Hamza Salla** në vlerën 500 (pesëqind) lekë, përkatësisht 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit.
- Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota, secila me vlerë të barabartë prej 500 (pesëqind) lekë, të zotëruara nga dy ortakët.

Neni 6

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 7

Organet e shoqërisë


Organet e kësaj shoqërie janë Asambleja e Ortakëve e përbërë nga ortakët Kelvin Kalari dhe Hamza Salla (ortakë me kuota të barabarta), të cilët do jenë dhe bashkëadministratorë të shoqërisë.

Neni 8

Legjislacioni

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9



Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË

“Benvenuto” Shpk

Kelvin Kalari

Kelvin Kalari



Hamza Salla

Hamza Salla

